REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 324/19
Datë/Datum 21.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit: Policia e Kosovës OE ankues: "Sigal Uniqa Group Austria"	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP 324/19
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit _____		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 324/19 të parashtruar nga OE "Sigal Uniqa Group Austria" - Prishtinë		
Datë	21.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës: 18.06.2019, me nr. 324/19 të parashtruar nga OE "**Sigal Uniqa Group Austria**" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e sigurimit të automjeteve të PK-së"**, me numër të prokurimit: **214-19-1219-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Policia e Kosovës.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – POLICIA E KOSOVËS.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA.

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		19.06.2019	**21.062019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 18.06.2019, OE "Sigal Uniqa Group Austria" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Sigma Interalbanian Vienna Insurance" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbimet e sigurimit të automjeteve të PK-së"**, me numër të prokurimit: **214-19-1219-2-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Policia e Kosovës.**
Ankesa nuk është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "Sigal Uniqa Group Austria" - Prishtinë.

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues "Sigal Uniqa Group Austria" - Prishtinë, janë:
Neni 1 - Qëllimi;
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve;
Neni 60 – Kriteret për dhënie të kontratës.

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë te njëjta.

Po [x] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Te bashkëngjitur gjeni kërkesën për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 ***NENI 1;6; 7 ;NENI 59 dhe 60***

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues -Policia e Kosovës ka përzgjedhur një kompani fituese ne kundërshtim te plote me **Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 me saktësisht me nenet e cekura me larte dhe atë:**

Përzgjedhja e fituesit është ne kundërshtim te plote me NENI-in 1.0 pika 1.0

Duke mos siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë , me ketë veprim te kundërligjshëm AK i ka shkaktuar dëme buxhetit për shumën **24,281.33€.**

Përzgjedhja e fituesit është ne kundërshtim te plote me NENI-in 59 pika 4.0

Oferta e jone i ka plotësuar te gjitha kriteret e dosjes se tenderit duke qenë e përgjegjshme por eliminimi i ofertës tone është ne kundërshtim me NENIN 59 pika 4.0 ku shkruan qarte :

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Përzgjedhja e fituesit është ne kundërshtim te plote me NENI-in 60 pika 1.1

AK ka përzgjedhur ofertën fituese ne kundërshtimin ne piken 1.1 te NENI 60 për faktin qe oferta e jona i ka plotësuar te gjitha kriteret e kërkuara dhe ka patur çmimin me te lire .

Kundërshtimi i eliminimit te ofertës tone : Arsyeja për eliminimin është e paqëndrueshme dhe konsiderojmë se ky veprim është me tendence te hapur për diskualifikim te ofertës tone e cila ka dëshmuar referenca ne pesëfishin e kërkuar

- **Sigal Uniqa Group Austria** sha ka dëshmuar referenca ne vlere mbi 1.5 milion Euro qe është pesëfishi i kërkesës sipas pikës 9.1&9.2 pika 1 (300,000.00€) .
- Te gjitha referencat kane qene pjese e dosjes dhe për disa sqarime qe janë kërkuar ne ju kemi dërguar përgjigjen shume te qarte por fatëkeqësishte po vërehet se komisionit vlerësuar nuk i kane interesuar fare përgjigjet e as dëshmitë qe kane qene pjese dosjes .
- Ne listën e prezantuar për kontratat e realizuara janë dhënë ne detaje dhe dëshmi për kontrata te realizuara te dëshmuara me letër referenca dhe atë:

1. **Referenca e lëshuar nga Raiffeisen Leasing ne vlere prej : 838,171.31€ për vitin 2017 dhe 2018 e lëshuar me date 19.02.2019 , është e mjaftueshme për te përmbushur kriterin 9.1&9.2 pika 1 te dosjes se tenderit**
2. **Referenca e lëshuar nga Raiffeisen Leasing ne vlere prej : 856,408.83 për vitin 2014 -2015 dhe 2016 e lëshuar me date 22.11.2017 ,pas sqarimeve shtese iu është sqaruar me dëshmi vetëm vlera për vitin 2016 qe kap shumën 215,979.89 €**
3. **Referenca e lëshuar nga KEDS JSC ne vlere prej : 359,629.00€ po ashtu edhe kjo reference si e vetme e ka përmbushur kriterin 9.1&9.2 pika 1 te dosjes , por edhe sikur te jete marre vetëm periudha 2016-2017 kjo reference ka vlere 236,000.00€ e cila se bashke referencën e Raiffesien leasing te datës 22.11.2017 apo referenca tjera si ajo e Doganës se Kosoves me vlere prej 33,637.97€ + Referenca e trafikut urbane 35,057.80€+ referenca e MPMS 33,600.00€ =33,637.97+35,057.80+33,600.00€=102,295.77€ +236,000.00 = 338,295.77 € e përmbushin kushtin e kërkuar sipas 9.1&9.2 pika 1 te dosjes se tenderit .**

Nuk qëndron arsyetimi mbi eliminimin e ofertës edhe për faktin qe asnjëherë nuk është kërkuar nga AK Polica e Kosoves qe te dëshmojmë se cilat kontrata janë aktive apo kanë skaduar.

Përmes sqarimeve shtese dhe është kërkuar kontrata me KEDS dhe ju kemi dorëzuar dhe shihet qarte se kontrata është lidhur ne 2016 me mundësi vazhdimi dhe është vazhduar edhe për 2017 ndërsa kontrate e re është lidhur ne 2018 ,ku janë shtypur te gjitha policat me dhe presim te vazhdohet edhe për një vite .

Kontrata për ndërmjetësim me Raiffeisen Leasing e lidhur ne 2014 është valide për një vit sipas NENIT 15 te kontratës dhe me mundësi ripërtëritje sipas NENIT 12 te kontratës , Te bashkëngjitur gjeni edhe një kopje te kontratës .

Te bashkëngjitur i gjeni kontratat :

1. **Kontrata Raiffeisen Leasing nr 002/14 –kontrate me vlefshmëri një vjeçare me mundësi te vazhdimi /ripërtëritjes ,andaj referencat e lëshuar nga Raiffisen Leasing janë te vlefshme dhe tregojnë se për çdo police te lëshuar brenda periudhës 2016-2018 ,kompania jone i ka përmbushur te gjitha detyrimet e police mbajtësit dhe për verifikim munde ti drejtoheni lëshuesit te referencës**
2. **Kontrata me Raiffeisen Bank JSC kontrate e lidhur ne 2011 një vjeçare me mundësi vazhdimi/ripërtëritjes dhe e amandamentuar ne 2013 - andaj referencat e lëshuar nga Raiffeisen BANK JSC është e vlefshme dhe tregon se për çdo police te lëshuar dhe e përfunduar brenda periudhës 2014-2016 ,kompania jone i ka përmbushur te gjitha detyrimet e police mbajtësit dhe për verifikim munde ti drejtoheni lëshuesit te referencës .**
3. **Kontrata me KEDS me nr 25/2016;107/2016;192/2017; dhe 208/2017 kontrata te**

realizuara për vitin 2016 dhe 2017 si dhe kontratën 381/2018 dhe 456/2018 e realizuar për vitin 2018

4. Kontrata me Kuvendin e Republikës e lidhur ne 2014 dhe e përfunduar ne 2017
5. Kontratën me zyrën e Presidentin e lidhur ne 2016 dhe përfunduar ne 2017
6. Kontratën me Dogane e Kosoves e lidhur ne 2017 dhe e përfunduar ne 2018
7. Kontrata me Trafikun Urban e lidhur ne 2018 dhe e realizuar(përmbushur) ne 2018
8. Kontrata me MPMS e lidhur ne 2016 dhe e përfunduar ne 2018
9. Kontrata me KUR Prishtine e lidhur ne 2016 dhe e përfunduar ne 2018
10. Kontrata me MPB e lidhur ne 2016 me kohëzgjatje 36 muaj – me vlere prej 93,000.00€ ndërsa referenca është lëshuar për policat qe janë realizuar për dy vitet dhe për këtë vlera e referencës është 59,510.66 €

Për vëmendjen tuaj: Kontratat munde te lidhen me periudha te ndryshme sipas LPP me institucione publike dhe atë (1 vjeçare, 2 vjeçare, dhe 3 vjeçare) ndërsa me kompani private kontratat munde te lidhen me afate te pa caktuara por është me rëndësi te kuptohet se çdo reference e lëshuar nga cili do autoritet dëshmon për se ne kemi përmbushë te gjitha kushtet e kontratës për policat e lëshuara për çdo institucion apo klient.

Nëse AK –Polica e Kosoves ka dyshime se referencat janë leshur pa mbulese atëherë te merr konfirmimin nga Autoritet qe kane leshur referencat dhe jo te nxjerre vendime sipas dëshirave te individëve qe janë ne kundërshtim te plote me ligjin .

Ne baze te ligjeve dhe rregulloreve ne fuqi për sigurimet motorike :Çdo police TPL ,TPL+ dhe KASKO është me afat max një vjeçar dhe secila police është vlefshme dhe dëmshpërblen për periudhën sa është vlefshme dhe pas skadimit te saj ajo police është mbyllur apo përfunduar andaj edhe i lejohet çdo institucioni publik apo privat qete lëshojë reference për policat e realizuara dhe te përfunduara .

Kërkojmë nga AK –Policia e Kosoves qe te Rishqyrtoje vendimin dhe rivlerësoje ofertat ne pajtim me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe kërkesat e dosjes se tenderit .

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke u bazuar ne ofertën e dhënë ,konsiderojmë se demet janë afro 70,000.00€ .
Ndërsa përveç demit financiar ka ndikime ne zhvillimin e kompanisë pasi qe SIGAL UNIQA Group Austria ka te punësuar mbi 150 punonjës dhe veprimet e tilla reflektojnë direkt ne kompani .

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë	29.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar	Kontratë publike kornizë, Shërbim
Vlera e parashikuar e kontratës	322,028.56€
Kriteri për dhënie të kontratës	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave	08.05.2019
Data e hapjes së ofertave	08.05.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave	07.06.2019
Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të eliminuar	07.06.2019
Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës	07.06.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim	11.06.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim	11.06.2019

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë neni 65 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin. No. 05 L-092, do të dorëzohen në formë të Aneksit 2.

b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

c) Vërtetimin nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument te lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës.

d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

b) Vërtetim nga Administrata Tatimore.

c) Vërtetim nga Gjykata ThemeloreDepartamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar.

d) Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje e noterizuar.

Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të

refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa 1 Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Çertifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet te regjistroj përfaqësinë ne Kosovë para nënshkrimit te kontratës).
Kërkesa 2 Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor)
Kërkesa 3 Certifikata me Numër Fiskal (për Operatoret Ekonomik vendor).
Kërkesa 4 Certifikatë e Licencës për Kompani të Sigurimit , me të cilën autorizohet të kryejë biznes sigurimesh në territorin e Kosovës e lëshuar nga BQK.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmi 1 Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit e lëshuar nga Agjensioni per Regjistrimin e Bizneseve ne Ministrine e Tregtise dhe Industrise (kopje).
Dëshmi 2 Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor).
Dëshmi 3 Numri Fiskal i lëshuar (Kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor).
Dëshmi 4 Certifikatë e Licencës për Kompani të Sigurimit (Licenca nga BQK) kopja.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
N/A
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuara me sukses kontrata të natyrës se njëjte gjatë 3 (tri) vitet e fundit 2016, 2017, 2018 ne vlerë minimum 300,000.00 €.
Kërkesa 2 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi me shkrim se në rast të shpërblimit me kontratë, Ju do të merrni përsipër të gjitha obligimet për kompensimin e dëmit Autoritetit Kontraktues.
Kërkesa 3 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi me shkrim se në rast të shpërblimit me kontratë, Ju do të merrni përsipër sigurimin e plotë 100 % të sigurimeve (full casco).
Kërkesa 4 Sigurimi 100% i automjeteve nga vjedhja, zjarri, protestat dhe katastrofave tjera natyrore pavarësisht vend ndodhjes së ngjarjes brenda territorit te Republikës se Kosovës.
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmi 1 Operatori Ekonomik duhet te ofroj listën e kontratave të përfunduara gjatë tri viteve të fundit 2016, 2017,2018 , të nënshkruar dhe vulosur nga Operatori Ekonomik të dëshmuar me referenca ose flete pranime në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit ne vlere minimum 300,000.00€.
Dëshmi 2 Deklaratë me shkrim se në rast të shpërblimit me kontratë, ju do të merrni përsipër të gjitha obligimet për kompensimin e dëmit Autoritetit Kontraktues të shkaktuar nga automjetet që bartin sigurimin e kompanive tjera të sigurimit. Duke marrë përsipër, po ashtu të gjitha angazhimet e domosdoshme dhe procedurat lidhur me kompensimin e dëmit - Deklarata të nënshkruhet dhe të vuloset;
Dëshmi 3 Deklaratë me shkrim se në rast të shpërblimit me kontratë, Ju do të merrni përsipër sigurimin e plotë 100 % të sigurimeve (full casco), pa zbritje të detyrueshme (frashisë) d.m.th. pa asnjë lloj participimi nga Autoriteti Kontraktues. Operatori Ekonomik obligohet për kompensimin e dëmeve për sigurimet CASCO në vlerë prej 100 % - Deklarata të nënshkruhet dhe të vuloset
Dëshmi 4 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi me shkrim për sigurimin e 100% të automjeteve nga

vjedhja, zjarri, protestat dhe katastrofave natyrore pavarësisht vend ndodhjes së ngjarjes - Deklarata të nënshkruhet dhe të vuloset.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatorët ekonomik	Vendi	Çmimi/€	Vërejtje
1.	"Sigma Interalbanian Vienna Insurance"	Prishtinë	210,639.17€	JO
2.	"Sigal Uniqa Group Austria"	Prishtinë	186,358.67€	JO
3.	"El-Sig"	Prishtinë	320,989.49€	JO
4.	"Pri Sig"	Prishtinë	238,049.25€	JO
5.	"Scardian"	Prishtinë	198,916.07€	JO
6.	"Euro Sig"	Prishtinë	310,717.09€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Besnik Mehmeti – Kryetar i komisionit
- Sami Franca – Anëtar i komisionit
- Haki Hasani – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

1). OE El-Sig, është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes lidhur me kontratat dhe referencat.

2). OE Pri Sig, është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes lidhur me kontratat dhe referencat.

3). OE Scardian, është i papërgjegjshëm sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes lidhur me kontratat dhe referencat.

4). OE Euro Sig, është i pa përgjegjshëm, sepse nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes lidhur me kontratat dhe referencat.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues:

Nr.	Emri i operatorëve ekonomik që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm	Vendi	Çmimi
1.	**Sigma Interalbanian Vienna Insurance**	**Prishtinë**	**210,640.00€**

Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardh në përfundim se OE ofertues "Sigma Interalbanian Vienna Insurance" është i përgjegjshëm dhe të njëjtin e kanë rekomanduar për kontratë, me çmim prej: 210,640.00€.

Rekomandimi i komisionit vlerësues është aprovuar nga Menaxheri i prokurimit.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Sigal Uniqa Group Austria" - Prishtinë.

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk e ka plotësuar kërkesën lidhur me kontratat dhe referencat, konkretisht komisioni vlerësues pasi qe ka pasur paqartësi ne lidhje me disa referenca, se a janë kontratat aktive për disa referenca. Përgjigje e OE për sqarimet e kërkuara ka specifiku se kontratat janë aktive dhe kjo është sipas kriterit te kërkuar ne dosje te tenderit bazuar ne LPP, RrUOPP dhe te pyetjet e shpeshta ne ueb faqen e KRPP-se, përgjigja nr. 57, gjithashtu referencat tjera nuk i plotësojnë kriterin e kërkuar ne dosje te tenderit për realizimin e kontratave për tri vitet e fundit ne vlere minimum 300,000.00€.

Eksperti shqyrtues, lidhur me arsyen e eliminimit te OE ankues sqaron se AK-ja, ka gjate vlerësimit te ofertës se OE ankues i ka vërejtur disa paqartësi ne listën e kontratave dhe referencave lidhur me periudhat kohore për te cilat është lëshuar referenca, për vlerat e referencave dhe periudhat e realizimit dhe njëherit eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne oferte e tij e ka dorëzuar listën e kontratave dhe referencat.

AK-Policia e Kosovës me datën 23.05.2019, lidhur me paqartësitë e lartpërmendura ka kërkuar sqarim nga OE ankues, konkretisht ka kërkuar sqarim për kontratën me nr. rendor 1, 2, 3 dhe 8 te listës se kontratave.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues pas pranimit te kërkesës se AK-se, për sqarim me datën: 27.05.2019 kthen përgjigje sipas kërkesës se AK-se duke ja bashkangjitur edhe kontratat për referencat e dorëzuar.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ne përgjigje te kërkesës se AK-se i ka dorëzuar këto kontrata:

1. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 25/2016, vlera: 59,000.00€.
2. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 381/2018, vlera: 51,750.00€.
3. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 107/2016, vlera: 60,000.00€.
4. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 208/2017, vlera: 60,000.00€.
5. Kontratë e lidhur me KEDS, me nr: 456/2018, vlera: 69,879.00€.

Vlera totale e kontratave arrin ne 300,629.00€ dhe për te gjitha kontratat e lartpërmendura gjendet edhe referenca e lëshuar nga KEDS.
Vlen te përmendet fakti qe ne te njëjtën referencë është e shënuar edhe një kontratë me nr: 192/2018 me vlerë 59,000.00€ por qe nuk ka bashkangjitur kontratë me nr. 192/2018.

Ne vazhdim eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ka dorëzuar edhe referenca tjera:

1. Referencë te lëshuar nga AK-MPMS, e lidhur me datë: 23.02.2016-24.02.2018, vlera: 33,600.65€.
2. Referencë te lëshuar nga AK-Trafiku Urban, e lidhur ne vitin 2018, vlera: 35,057.80€.
3. Referencë te lëshuar nga AK-Komuna Prishtinë, për periudhën 2016, 2017 dhe 2018, vlera: 58,614.32€.

Vlera totale e Referencave te lartpërmendura arrin ne 127,272.77€.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne oferte ne tij OE ankues i ka dorëzuar edhe disa referenca te cilat kanë kontradikta ne mes te referencës dhe kontratës siç është rasti te referenca dhe kontrata me Raiffeisen Bank, pastaj ka referencë projekti i te cilës nuk ka përfunduar dhe nuk mund te merret parasysh një kontratë e papërfunduar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2
Eksperti shqyrtues, ne fund te analizimit dhe shqyrtimit te arsyes se eliminimit, sqaron se AK-ja, ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se e ka eliminuar për faktin se OE ankues ne sqarimin e datës: 27.05.2019, i ka ofruar kontratat me te cilat ka dëshmuar se e arrin vlerën e kërkuar sipas kërkesës se dosjes se tenderit ne vlerën prej: 300,000.00€.
Prandaj, ne bazë te dëshmive te ofruara eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues vetëm me kontratat dhe referencat e lartshënuara arrin vlerën prej: 427,901.77€.
Vlen te përmendet fakti se OE ankues ne përgjigje te kërkesës se AK-se për sqarim i ka dorëzuar edhe disa raporte te polisave te sigurimit me Raiffaisen Bank dhe me Kuvendin e Kosovës ne vlerë prej: 222,288.18€.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.